

URDHËR
Nr. 83/1, datë 10.5.2012

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË URDHRIN NR. 83, DATË 10.2.2012 “PËR
RREGULLAT DHE PROCEDURAT E SHITJES SË PRODUKTEVE HIDROKARBURE
(NAFTË BRUTO)”**

Në mbështetje të nenit 102 pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenit 1 të aktit normativ nr. 2, datë 18.6.2010 “Për një shtesë në ligjin nr. 7746, datë 28.7.1993 “Për hidrokarburet (kërkimi dhe prodhimi)”, të ndryshuar, miratuar me ligjin nr. 10 298, datë 8.7.2010, të ligjit nr. 9874, datë 14.2.2008 “Për ankandin publik”, të ndryshuar, si dhe vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 1719, datë 17.12.2008 “Për miratimin e rregullave të ankandit publik”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

Në urdhrin nr. 83, datë 10.2.2012 “Për rregullat dhe procedimet e shitjes së produkteve hidrokarbure (naftë bruto)”, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Pas paragrafit të dytë të germës “d”, në pikën 12, në fund të shtohet shprehja:
“...me kusht që diferenca e vlerës së ofertës së parë me vlerën e ofertës së dytë të mos jetë më e lartë se vlera e sigurimit të ofertës...”

2. Paragrafi i 3-të i germës “dh” të pikës 12, riformulohet:

“...Kriteri bazë i vlerësimit të ofertës të jetë oferta e kualifikuar me çmimin më të lartë...”

3. Paragrafi i parë i pikës 11 riformulohet:

“Pas miratimit të dokumenteve të ankandit, titullari i autoritetit shitës apo nëpunësi i autorizuar bën publikimin e procedurave të shitjes duke i botuar ato në dy gazeta kombëtare, si dhe në faqet zyrtare të “Albpetrolit” sh.a. dhe të Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, për 7 ditë kalendarike nga data e publikimit.”

4. Paragrafi 3 i pikës 11 riformulohet:

“Në njoftim shënohet edhe se dokumentet e ankandit mund të tërhiqen në rrugë elektronike nga adresat zyrtare të “Albpetrolit” sh.a. dhe të Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës.”

5. Paragrafi 13 i pikës 14 riformulohet si më poshtë:

“Pas miratimit të raportit përmbledhës, titullari i autoritetit shitës u dërgon menjëherë një njoftim pjesëmarrësve.”.

6. Pas paragrafit të parë të pikës 19 shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:

“Kundërshtimi i vendimit të komisionit të shitjes bëhet pranë titullarit të autoritetit shitës brenda 5 ditëve kalendarike nga data e marrjes së njoftimit. Kundër vendimit të titullarit, pjesëmarrësit në ankand kanë të drejtën e ankimit në Gjykatë, sipas afateve të Kodit të Procedurave Administrative. Ankimi nuk pezullon vazhdimin e procedurave.”

7. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohet shoqëria “Albpetrol” sh.a. Patos, Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve Mbështetëse, si dhe njësia që mbulon aktivitetin hidrokarbur në METE.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I EKONOMISË, TREGTISË
DHE ENERGJETIKËS
Nasip Naço